

20242183771

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË MEDIAVE

Neni 1

Në Ligjin e Mediave (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 184/13 dhe 13/14 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 63/24 dhe 74/24), në nenin 28-b, në paragrafin (4) fjalët “shoqëri e informatikës dhe administratës” zëvendësohen me fjalët “transformim digjital”.

Neni 2

Në titullin e nenit 30, fjalët “Dispozita ndëshkuese” zëvendësohen me fjalët “Dispozita kundërvajtëse”.

Neni 3

Në nenin 30, paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

“(2) Gjobë në shumë prej 250 deri në 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtjen e kryer nga paragrafi (1) i këtij neni.”.

Pas paragrafit (2) shtohet paragrafi i ri (3), si vijon:

“(3) Gjobë në shumë prej 100 deri në 250 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet tregtarit individual për kundërvajtje të kryer nga paragrafi (1) i këtij neni.”.

Neni 4

Në nenin 31 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

“(2) Gjobë në shumë prej 250 deri në 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtjen e kryer nga paragrafi (1) i këtij neni.”.

Pas paragrafit (2) shtohet paragrafi i ri (3), i cili vijon:

“(3) Gjobë në shumë prej 100 deri në 250 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet tregtarit individual për kundërvajtjen e kryer nga paragrafi (1) i këtij neni.”.

Neni 5

Pas nenit 31, shtohet nen i ri 31-a, si vijon:

“Neni 31-a

Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj, procedurë për kundërvajtje udhëheq dhe sanksione kundërvajtëse shqipton gjykata kompetente në pajtim me Ligjin e Kundërvajtjes.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.